



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni Hetimor "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore."

Nr. ____ Prot.

Tiranë më 18.09.2019

Lënda: Kërkesë për zgjatje të afatit të veprimtarisë së komisionit të hetimor

Drejtuar: Z. GRAMAZ RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar zoti RUÇI,

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin Nr.84/2019 vendosi ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Bazuar në pikën VI të këtij vendimi, afati i ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit është caktuar 3 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit, e konkretisht deri në datën 08.10.2019.

Komisioni hetimor, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", me vendimin e ndërmjetëm nr.4, datë 15.07.2019 vendosi t'i drejtohet për një opinion Komisionit të Venecias, mbi aspekte në lidhje me çështjen objekt hetimi, që janë në fokus të ekspertizës së Komisionit të Venecias.

Në datën 11.09.2019 një delegacion i Komisionit të Venecias u takua me anëtarët e Komisionit Hetimor. Gjatë këtij takimi perfaqësuesit e delegacionit vunë në dijeni anëtarët e Komisionit se opinioni lidhur me kërkesën objekt hetimi do të shqyrtohet dhe miratohet në Mbledhjen Plenare të Komisionit të Venecias në datat 11-12 tetor 2019.

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm marrjen dhe administrimin e opinionit nga ekspertët e Komisionit të Venecias, si dhe të çdo informacioni tjetër objekt të hetimit, në zbatim të afateve të përcaktuara me ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, Komisioni Hetimor, me vendimin e ndërmjetëm nr. 8, datë 18.09.2019, vendosi t'ju drejtohet me një kërkesë për zgjatjen me 2 muaj të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor.

Me konsideratë,

KRYETAR

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni Hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.”

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 8, datë 18.09.2019

“PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR”

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2019, bazuar në nenin 13, pika 2, në nenin 14, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe nenit 7, pika 1, nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

VENDOSI:

- I. T’i drejtohet Kryetarit të Kuvendit, Z.Gramoz Ruçi me një kërkesë për zgjatjen me 2 muaj të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ulsi MANJA